

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 12, 16 - 22 MARS 2015

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUJË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZH, LUSHNJË, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS “ALERT” NË JAVËN 12

	JAVA 12
DIARRE PA GJAK	1.138
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	9.054
INF. RESP. TE POSHTËME	5.231
RASH ME TEMPERATURË	5
VERDHEZA	3
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	0
Numri i Njësive Raportuese	400
% e Njësive Raportuese	94% (400/427)

Rash me temperaturë

4 raste janë raportuar nga rrethi i Fierit dhe 1 rast nga rrethi i Matit. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rrethit, rastet nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.

Duke u nisur nga shpërthimet epidemike që po ndodhin në disa shtete të Europës dhe Ballkanit, në komunikimin me epidemiologët e rretheve është theksuar përforcimi i Survejancës së sindromit “rash makulopapular me temperaturë” nga mjekët Pediatër dhe Infeksionistë dhe marrja e mostrave të gjakut nga rastet e suspektuara.

Mostrat e analizuara nga rastet e suspektuara për Fruth nga rrethi i Fierit dhe i Pogradecit kanë rezultuar negative për IgM ndaj Fruthit dhe Rubeolës.

Jane marrë mostra gjaku nga fëmijët me diagnozë Varicelë për konfirmim në ISHP.


2 nga mostrat e marra ne rrethin e Fierit rezultuan pozitive per IgM ndaj virusit të Varicelës.

Verdhëz


2 raste të grupmoshës 15-44 vjeç dhe 60+vjeç janë raportuar nga rrethi i Fierit. Më pas diagnoza rezultoi “Hepatit viral i paspecifikuar”.

1 rast i grupmoshës 5-14 vjeç është raportuar nga rrethi i Mirditës. Më pas diagnoza rezultoi “Hepatit viral i paspecifikuar”.

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet ritje në javën e 12 krahasuar me javën paraardhëse, java 11.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i “Diarreve pa gjak” paraqet ritje në javën e 12 krahasuar me javën paraardhëse, java 11.

Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 01 – 12 të vitit 2014 dhe të vitit 2015. Numri i rasteve.




Në javën e 12 të vitit 2015 vërehet trend në ritje i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 12% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rrethëve në javën 11 dhe javën 12 të vitit 2015. Incidenca (raste/10.000)




Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën 12-të të vitit 2015. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)



Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 40 – 12 të vitit 2014 dhe të vitit 2015. Numri i rasteve.



Në javën e 12 të vitit 2015 vërehet një trend në ritje i numrit të rasteve të “Diarre pa gjak” dhe ky numër është 6% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 11 dhe javën 12 të vitit 2015. Incidenca (raste/10.000)



Shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nivelet e Raportimit për javën e 12 sipas rretheve, në përqindje.

